




# DEMOKRACIA DHE ROLI I SAJ


# NE KEMI RËNDËSI NË DEMOKRACI

DINETA (12), RIGA (12), SIBORA (12), KRON (12), AMAR (12), OLTA (12)



## I dashur lexues, nëse dëshiron të dish më shumë për rolin e demokracisë, lexo artikullin tonë

Ne jemi qytetarë të një shteti ku mbizotron dhe është e zhvilluar demokracia. Në shtetin tonë, po ashtu, kemi shumë të drejta të cilat i zbatojmë. Elementet kryesore të demokracisë të cilat e karakterizojnë atë janë: toleranca, barazia, solidariteti, liria, paqja etj. Demokracia për herë të parë u formua në kryeqytetin e Greqisë në Athinë në vitin 507 para erës sonë. Aso kohe në mbledhjet e shtetit, merrnin pjesë vetëm burrat e pasur që kishin shumë prona. Pra gratë, të varfërit dhe të moshuarit ishin të anashkaluar. Në demokracinë e tashme të drejtën e votimit e kemi të gjithë njerëzit nga moshja 18 vjeçare. Të mos harrojmë se demokracia është mënyra e udhëheqjes së shtetit nga populli me anë të votave. Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke „demos“, që do të thotë popull dhe „kratia“, që do të thotë udhëheqje. Demokracia tani është shumë më ndryshe dhe shumë më e zhvilluar. Demokracia ndahet në demokraci të drejtpërdrejtë dhe në demokraci përfaqësuese. Demokracia e drejtpërdrejtë është atëherë kur populli i merr vet vendimet në lidhje me shtetin. Ndërkaq, demokracia përfaqësuese është atëherë kur populli i zgjedh përfaqësuesit e vet të cilët janë deputetët. Këtë lloj të demokracisë e kemi edhe ne në Kosovën tonë. Ne i porosisim lexuesit dhe bashkëmoshatarët tonë që të mësojmë sa më shumë dhe t'i zbatojnë parimet e demokracisë në vendin tonë.



Autorët e artikullit



## EJA EDHE TI ME NE

MUSLI (13), EDA (12), ALTIN (12), KORAB (12), RINESA (12), DENISA (12)

### Roli i qytetarëve aktiv

Të jesh qytetar aktiv do të thotë të japësh kontribut për një lagje, shtet apo edhe për të gjithë botën. Qytetarët aktiv kanë përgjegjësi. Ata luajnë rol shumë të rëndësishëm.

Qytetarët aktiv kontribuojnë në mënyrë vullnetare për të mirën e një populli. Ata veprojnë në bazë të disa parimeve: barazisë, diversitetit, gjithëpërfshirjes, drejtësisë, etj. Në demokraci ne si fëmijë kemi shumë të drejta dhe ato janë: e drejta e mësimi, shkollimit, e drejta e strehimit, e drejta e familjes, e drejta e lojës, e drejta e pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme, e drejta e kombësisë, e drejtën e të shprehurit lirshëm etj. Ne kemi shembuj të ndryshëm për qytetarët aktiv si

p.sh: kur qytetarët kanë iniciativë për të pastruar qytetin ose lagjën e tyre ose kur ndihmojnë të varfërit me shpërndarjen e rrobave ose ushqimit për ta. Për t'i realizuar këto veprime, mund të formojnë një shoqatë ose organizatë ku të gjithë njerëzit mund të marrin pjesë vullnetarisht. Të gjitha këto organizata mund të jenë qeveritare dhe joqeveritare. Populli në demokraci ushtron sovranitetin e tij, pra kjo do të thotë ka rol vendimmarrës për çështjet me interes të përbashkët. Demokracia është sundim i popullit nga shumica. Pra ne mësuam se duhet të jemi të vetëdijshëm për ato që bëjmë dhe ne duhet që t'i respektojmë të gjithë pa dallim race, gjinie apo feje.



Bashkimi bën fuqinë



Gazetarët e artikullit



Votimet bëhen nga qytetarët



Mjedisi ku jetojmë është shumë i rëndësishëm

## QEVERISJA E POPULLIT

MELOS (12), ALTIN (12), EDINA (12), ELONA (12), ELSA (12), ELBATRIN (12)



### Ne jemi gazetarët e Kuvendit të Kosovës. Jemi nga klasa VII-1 shkolla fillore „Pjetër Bogdani“ në Prishtinë. Ne duam të flisnim për qeverisjen e popullit

Diskutimin e filluam duke biseduar për demokracinë dhe ndarjen e pushtetit.

Siç e diskutuam pushteti ndahet në tri degë: dega Legjislative që ka për institucion kryesor Kuvendin e Kosovës, Ekzekutivi që ka si institucion kryesor Qeverinë dhe gjyqësori që ka si institucion kryesor gjykatat.

Në Kuvendin e Kosovës punojnë gjithsej 120 deputetë. Legjislativ do të thotë ligjvënës dhe kjo i bie që ky institucion i miraton ligjet që vijnë nga Qeveria. Puna më e madhe në Kuvend, bëhet në komisionet parlamentare të Kuvendit të cilat janë komisione të përhershme dhe funksionale të Kuvendit.


Pushteti Ekzekutiv përbëhet nga Qeveria. Detyra e këtij institucioni është zbatimi i ligjeve në mënyrë që të përshtaten me Kushtetutën e Kosovës. Sipas diskutimit tonë, Qeveria ka për detyrë propozimin e ligjeve të Kuvendi.

Qeveria po ashtu, ka në dorë buxhetin e vendit dhe vendos ku do të shpenzohet ai buxhet. Kuvendi i Kosovës e kontrollon Qeverinë në përgjithësi. Këtë e bën duke i'u bërë pyetje ministrave dhe Kryeministrit gjatë seancave plenare.

Pushteti gjyqësor ka në përbërje gjykatat e vendit. Ne mësuam se në Kosovë ka 4 lloje të gjykatave. Ato janë: Gjykata e Apelit, Gjykata Themelore, Gjykata Supreme dhe Gjykata Kushtetuese. Të gjitha gjykatat merren me vënien e drejtësisë në vend, janë të pavarura dhe nuk i përkrahin Qeverinë apo Kuvendin.



Ne jemi gazetarët e këtij artikulli





Detyrat kryesore të Kuvendit të Kosovës



**Pse është e rëndësishme të ndahen punët e institucioneve udhëheqëse në Kosovë?  
Këtë mund ta mësoni në artikullin më poshtë**

Institucionet e përmendura nga ne më lart punojnë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra. Ato nuk e ndihmojnë njëra-tjetrën, sepse kanë pushtet në vete. Secila ka funksion të caktuar dhe secila ka punë të ndara. Ne e dimë se kur ndajmë punët, ndajmë edhe përgjegjësitë. Ne kur planifikojmë pastrimin e dhomës së klasës, ne duhet të ndajmë përgjegjësitë. Dikush nga ne pastron bankën, dhe dikush tjetër tabelën, etj. Ne mendojmë se nëse pushteti nuk do të ndahej, këto institucione do të abuzonin me pushtetin në favor të tyre duke bërë padrejtësi ndaj popullit. Nëse njëri nga këto institucione do të kishte më shumë pushtet do të shkeleshin të drejtat e barabarta të njeriut, dhe institucioneve të tjera do t'iu humbiste rëndësia. Për ne është e rëndësishme si qytetarë të Kosovës të balancohet pushteti, sepse shteti ynë do të zhvillohet dhe do të ecën përpara.




Funksionet e Kuvendit të Kosovës



Grupi gjatë punës




Pushteti i ndarë në Kosovë



Tri institucionet kryesore të Kosovës

## NE VENDOSIM, JU VEPRONI

ANESË (12), ADELINA (12), LEONA (11), GENTRIT (12), ADEA (12), ERON (12)



### Zgjedhjet janë të lira, të përgjithshme, të fshehta dhe të drejtpërdrejta

Zgjedhjet janë fenomeni më i shpeshtë që ne si qytetarë i hasim (takojmë). Të zgjedhësh, do të thotë të vendosësh ose të përcaktohesh për diçka që ne mendojmë që është më e mira për ne si qytetarë.

Zgjedhjet janë elementi bazë i demokracisë, sepse me anë të zgjedhjeve disa individ (parti të ndryshme) vihen në pushtet dhe qeverisin vendin për katër vite.

Në Kosovë kemi dy lloje zgjedhjesh: zgjedhje lokale dhe zgjedhje qendrore. Në zgjedhje lokale, qytetarët votojnë për kryetarët e komunave dhe asambleistët, mandati i të cilëve është katër vjet. Duhet cekur se, kandidatët të cilët kandidojnë për kryetarë dhe asambleistë duhet të jenë qytetarë të asaj komune.

Kurse, në zgjedhje qendrore qytetarët votojnë për deputetët.

Qytetarët e Kosovës, mund të marrin pjesë në këto lloje zgjedhjesh pasi të arrijnë moshën 18 vjeçe. Pra, në këtë moshë qytetarët e Kosovës jo vetëm që e gëzojnë të drejtën të votojnë, por po ashtu edhe e fitojnë të drejtën që të kandidojnë qoftë për zgjedhjet lokale po ashtu edhe ato qendrore.

A është e rëndësishme vota jonë? Po. Ne mendojmë që vota e secilit qytetarë është e rëndësishme dhe ka një vlerë të madhe, sepse vetëm një votë mund të sjellë ndryshimin që të gjithë e kërkojnë.

Ti je ndryshimi, ne jemi ndryshimi. Për këtë është e rëndësishme e drejta e votës sepse ne vendosim për të ardhmen tonë.



Kosova voton



Autorët e artikullit



## DEPUTETËT E RINJË



Disa kadidatë për deputetë




Një punim ku tregon disa informata për deputetët

Deputetët ndryshe quhen edhe përfaqësues të popullit, sepse populli është ai i cili i zgjedh këta deputet. Të drejtën për të kandiduar për deputet e ka secili qytetar mbi moshën 18 vjeçare, kjo sepse kur arrin këtë moshë atëherë jemi më të pjekur dhe jemi të aftë të gjykojmë drejtë.


Deputetët zgjedhen me vota të drejtpërdrejta, të barabarta, të përgjithshme dhe të fshehta. Këta deputet kanë mandat 4 vjeçar.

Në Kosovë kemi gjithsej 120 deputet, 100 prej tyre kanë kombësi shqiptare, ndërsa 20 prej tyre janë prej komuniteteve jo shumicë.

Deputetët që të fitojnë votën tonë japin shumë premtime e këto premtime duhet t'i realizojnë.



Në këtë vizatim kemi paraqitur një deputet



Unë, si qytetare e Kosovës e gëzojë këtë të drejtë



Unë si qytetar i Kosovës, po ashtu e gëzojë këtë të drejtë



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pjetër Bogdani“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-1  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë